



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0733**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Gezime S. Gashi B.I., kundër Vendimit për dhënie të një kontrate të Kuvendi i Komunës së Prishtinës cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1, me 02/11/2023, mori:

## **Vendim**

I. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE Gezime S. Gashi B.I. me nr. 2023/0733, e datës 27/09/2023, kurse vendimi i Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1, anulohet dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

III. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 21.06.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me

pelet” me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1. Ndërsa me datën 11.09.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik “DHF COMPANY” sh.p.k.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 438,000.00 €.

Me 15.09.2023, OE Gezime S. Gashi B.I, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 18.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 27.09.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE. Gezime S. Gashi B.I., me nr. 733/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Gezime S. Gashi B.I., janë parashtruar si në vijim:

***Pretendimi*** Ankuesi pretendonse “Komisioni për Vlerësimin e ofertave dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk kanë qenë objektiv dhe nuk i kanë zbatuar më përpikëri kërkesat e LPP gjatë vlerësimit të ofertave dhe marrjes së vendimit për dhënien e kontratës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet”. Autoriteti Kontraktues Komuna Prishtinës në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet”, tek kriteret e përzgjedhjes ka përdorur termin “të ngjashme” që nuk përmendet në LPP dhe i cili dëmton konkurrencën e OE të cilët veprimtari të rregullt e kanë lëndën e kontratës “Furnizim me pelet”, me qëllim të favorizimit të OE që merren me furnizim me karburante. Për më tepër, për kapaciteti teknik dhe profesional në dosjen e tenderit është kërkuar: 1. Operatori duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për furnizime të ngjashme (lende djegëse) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë jo me pak se 400.000,00”. Dëshmia e kërkuar dokumentare: Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje e furnizimeve. Është shkëlur neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, i LPP-së – sepse Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i kanë trajtuar njëtrajtshëm OE pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet”. Nga Grupi i OE “RRON 2019 & N.P.T “METI COMERC” kanë kërkuar që të dorëzohen kontratat e realizuara në tri vitet e fundit, ndërsa nga OE DHF Company nuk i kanë kërkuar kontratat. OE DHF Company nuk ka ofruar dëshmi evidentuese për livrimin e

furnizimeve në tri vitet e fundit dhe Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i kanë kërkuar dëshmitë e tilla. Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk e kanë respektuar kërkesën e LPP dhe opinionin e KRPP-së për termin “të ngjashme” duke u bazuar në kategorizimin e fjalorit të përgjithshëm të prokurimit. Ne kemi kërkuar qasje në dokumente e dorëzuara të OE që i është dhënë kontrata dhe kemi gjetur se OE DHF Company nuk i ka dorëzuar kontratat për furnizime të ngjashme (lende djegëse) në tri vitet e fundit nga data e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë jo me pak se 400.000,00, por vetëm listën e kontratave. Ne nuk kemi gjetur dëshmi që Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në K.K. Prishtinë ka kërkuar sqarime nga OE DHF Company për dorëzimin e kontratave, ashtu siç ka kërkuar nga grupi i OE “RRON 2019 & N.P.T “METI COMERC”. Pra, OE DHF Company nuk i ka ofruar kontrata e nënshkruara.”

**Pretendimi i dytë (II):** Ankuesi pretendon se “Poashtu nga lista e kontratave shihet se të gjitha kontratat e paraqitura në listë e furnizimeve të ngjashme në tri vitet e fundit nga DHF Company janë me blerës privat dhe Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk i ka respektuar kërkesat e nenit 8.5 kriteret e përzgjedhjes të Udhëzuesit 001/2023 për Prokurim Publik, ku thuhet “Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë” dhe nga OE DHF Company nuk ka kërkuar asnjë. Në ofertën e DHF Company për furnizimet e realizuar në tri vitet e fundit janë ofruar vetëm referencat dhe asnjë dëshmi tjetër që evidenton liverimin e tillë. Referencat e ofruara nga DHF Company për ne nuk janë dëshmi të besuara së kontratat e tilla janë realizuar në të vërtetë, për arsytet si në vijim:

- Të gjitha referencat përmbajnë të njëjtin përshkrim në tekst, të njëjtin font të shkrimit dhe të njëjtën përmbajtje në tërësi, vetëm emërtimi i lëshuesit të tyre është i ndryshëm. Pra, referenca është bërë nga vet OE DHF Company, sepse secili blerës privat dhe kush do që lëshon referencë e ka mënyrën e vete të formatit të shkrimit dhe përmbajtjes së referencës. Referencat e tilla ngritin dyshime se janë fiktive dhe kërkojmë nga AK K.K. Prishtinë që t'i rishqyrtoj edhe njëherë dhe ta konfirmoj vërtetësinë e tyre.

- Të gjitha referencat nga OE DHF Company, janë marr pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” dhe në data për afërsisht të njëjta. Referencat nuk janë të mbështetura me ndonjë evidencë tjetër të liverimit të tillë, si p.sh., transaksionet bankare për furnizimet përkatëse.

Komisioni i Vlerësimit në K.K. Prishtinë nuk ka kërkuar nga OE DHF Company qartësim dhe plotësim të këtyre dokumenteve duke vepruar në kundërshtim me nenin 38, paragrafin 5 të RRPP, i cili thotë “Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE”.

Përveç kësaj, bazuar në dokumentet që janë prezantuar nga OE DHF Company i rekomanduar për dhënie të kontratës dhe në mungesë të kërkesave për sqarime të Komisionit për vlerësimi

dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, ne dyshojmë së OE DHF Company ka ofruar informata të pavërteta për furnizimet e realizuar në tri vitet e fundit. Ne kërkojmë nga Komisioni i Vlerësimit deh Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në K.K. Prishtinë që për të vërtetuar qarkullimin e prezantuar në listën e furnizimeve për tri vitet e fundit të kërkohej qarkullimi bankarë për këto kontrata. Dyshimi se furnizimet e prezantuara të OE DHF Company për OE të prezantuar në listën e furnizimeve në tri vitet e fundit, nuk kanë ndodhë shtohen edhe me shumë kur shihet se të gjitha kontratat e prezantuara në listën e furnizimeve përfundojnë në të njëjtën datë me 30.04.2023.

Pra, dëshmitë e ofruara nga OE DHF Company nuk janë bindëse dhe konfirmues së janë realizuar furnizimet e tilla siç janë prezantuar në listën e furnizimeve. Po ashtu furnizimet e prezantuara nuk kategorizohen në fjalorin e prokurimit publik FPP për lëndën e kontratës “Furnizim me pelet” për arsye se furnizimet e prezantuara nga OE DHF Company janë për karburante.

Nga kjo shihet se Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në K.K. Prishtinë nuk kanë ushtruar përgjegjësit e tyre të përcaktuara me LPP dhe legjislacionin sekondar dhe nuk ka kërkuar sqarime të OE DHF Company për ta konfirmuar vërtetësinë e kapaciteteve teknike dhe profesionale të OE DHF Company. ”

**Pretendimi i tretë (III):** Ankuesi pretendon se “Në nenin 27 “Dosja e tenderit”, paragrafin 3, i LPP dhe me nenin 17 “Dosja e tenderit, paragrafin 21 të RRPP, thuhet se furnizimet, shërbimet dhe punët që janë lëndë e kontratës duhet të përshkruhen me fjalorin e përgjithshëm të prokurimit (FPP) dhe kodeve të duhura. Kodi i duhur për furnizim me pelet sipas FPP 20161000-2 dhe është i ndryshëm me kodin e lëndës djegëse për të cilin i janë pranuar OE DHF Company furnizimet e ngjashme në tri vitet e fundit. Rrjedhimisht sipas opinionit të KRPP-së të datës 09.06.2013 si bazë për të përcaktuar termin “të ngjashme” përdoret edhe FPP. Në rastin konkret për lëndën e kontratës “Furnizim me pelet”, FPP është 20161000-2, ndërsa referencat dhe lista e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit të ofruara nga OE DHF Company, kategorizohen në FPP 23000000 Pra, K.K. Prishtinë nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe opinionin e KRPP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” dhe ka pranuar si furnizime të ngjashme listën e kontratave të kategorisë furnizim me karburante. - Është shkelur neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve duke mos shqyrtuar dhe vërtetuar informatat e prezantuara nga OE DHF Company. Grupi i OE “RRON 2019 & N.P.T “METI COMERC” kërkon nga OSHP, që kërkesa për rishqyrtim të trajtohet konform dispozitave ligjore të LPP dhe legjislacionit sekondar dhe pretendimet ankimore të zbardhin të vërteten duke e konfirmuar se informatat e dhënë nga OE DHF Company janë të vërteta. Pra, meqenëse OE DHF Company ka kryer furnizime për blerës privat, dokumentet e prezantuara në dosje nuk përcillen me dëshmi evidentuese nga institucionet të treta (siç janë pagesat në bankë) për liverimin e tillë, referencat e OE DHF Company janë identike për të gjithë blerësit, e njëra prej tyre tregon edhe lidhjen familjareve të pronareve, veprimtaria kryesore e OE DHF Company është furnizimi me karburante dhe jo me pelet, furnizimi me pelet dhe referencat e ofruara nga OE DHF Company nuk janë në të njëjtin kod të fjalorit të përgjithshëm të prokurimit.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE Gezime S. Gashi B.I, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 27, 59, 69 dhe 72 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 28/09/2023 ka autorizuar ekspertet për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 733/23, ndërsa me datë 09/10/2023 është dorëzuar raporti i eksperteve me nr. 2023/0733 me rekomandimet si në vijim: *“eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, duke theksuar *“ Ju shkruajmë në emër të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prishtinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pelet” me nr. të prokurimit 616-23-6338-1-1-1. Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit operatori ekonomik “Gëzime S. Gashi” B.I. me datë 27.09.2023 ka parashtruar ankesën me nr. 2023/0733. Me këtë rast ju konfirmojmë që ky aktivitet i prokurimit ka për qëllim lidhjen e një kontrate për furnizimin e çerdheve, shkollave fillore, shkollave të mesme dhe institucioneve të tjera me pelet (për ngrohje) sepse aktualisht nuk kemi një kontratë të tillë valide. Me fjalë të tjera aktiviteti i prokurimit është mjaft i rëndësishëm dhe i përket një natyre mjaft specifike pasi që ndërlihet drejtpërdrejtë me shëndetin e fëmijëve respektivisht nxënësve në institucionet shkollore. Duke qenë në prag të sezonit dimëror, mungesa e furnizimit me pelet nënkupton mungesën e ngrohjes në shkolla dhe rrjedhimisht mund të shkaktoj pasoja të pariparueshme për jetën dhe shëndetin e fëmijëve/nxënësve të Prishtinës. Ne kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues mirëpo nuk jemi pajtuar me rekomandimet e tij. Kjo për arsye se në këtë aktivitet të prokurimit është përzgjedhur tenderuesi më i lirë i përgjegjshëm sipas dosjes së tenderit. Në anën tjetër operatori ekonomik ankues është tenderuesi i tretë më i shtrenjtë që nënkupton se nuk ka fare interes material edhe po të veprohet sipas rekomandimeve të ekspertit shqyrtues. Përndryshe çdo zgjatje e panevojshme e kësaj procedure (anulimi apo rivlerësimi i aktivitetit) mund të rrezikoj që të mbeten me dhjetëra mijëra nxënës pa ngrohje në Komunën e Prishtinës. Kjo në mënyrë zingjirore mund të shkaktoj edhe ndërprerjen e plotë të procesit mësimor gjatë sezonit dimëror që më pas krijon edhe pasoja tjera anësore. Nga sa u tha më sipër, me mirësjellje kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të trajtoj këtë rast me procedurë të shpejtuar duke marrë në konsideratë edhe pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik në kuptim të nenit 104 paragrafi 3 të LPP”, ndërsa OE nuk është deklaruar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.*

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave -*

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Gezime S. Gashi B.I, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0733 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i bazuar pasi që “Eksperti Shqyrtues, duke e pasur parasysh që AK, lidhur me këtë aktivitet ka kërkuar sqarime nga OE ankues, duke ja kërkuar kontratat e realizuara në tri vitet e fundit, të njëjtën kërkesë duhet ta bëjë edhe për OE DHF Company shpk. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar dhe kërkohet nga AK, të respektohet Nenit 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

Pretendimi i dytë (II) ankimor është i bazuar pasi që “ Eksperti Shqyrtues, sipas këtij pretendimi të OE-ankues, ka verifikuar Listën e furnizimeve të realizuara në 3 vitet e fundit të cilat i ka prezantuar OE i rekomanduar për kontratë, ku shihet qartë se në listën e furnizimeve të realizuara në 3 vitet e fundit, titujt e kontratave, datat dhe muajt janë të njëjta, si dhe datat e përfundimit të kontratave janë të njëjta me të gjithë kontraktuesit si dhe referencat, të cilat janë të bashkangjitura të operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ku janë të prezantuar (6) gjashtë referenca të cilat janë të lëshuara me një datë, pra me Dt.; 06.06.2023, dhe (1) një referencë me datën 07.06.2023, ku të gjitha këto e kanë përshkrimin e njëjtë të kontratës. Andaj, mendoj që ky pretendim është i bazuar dhe rekomandoj autoritetin kontraktues, që të kërkojë dëshmi shtesë për të dëshmuar vërtetësinë e Listës së furnizimeve të realizuara si dhe referencat, sipas nenit 69 të LPP, pika 2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmitë këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmitë këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë.

Pretendimi i tretë (III) ankimor është i bazuar pasi që “Eksperti Shqyrtues, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore, dosjes së tenderit, shkresat e lëndës si dhe dëshmitë e dorëzuara në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, konstatoi se ky pretendim ankimor është i bazuar dhe se Autoritetit Kontraktues këtë aktivitet të prokurimit ta kthej në ri-vlerësim dhe njëherit të kërkojë nga OE i rekomanduar për kontratë dëshmitë e nevojshme në lidhje me referencat dhe listën e kontratave, duke e respektuar nenin 8 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik si dhe Ligjin e Prokurimit Publik, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë; 1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe

transparencës. 2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji. 3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i kanë trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues Gezime S. Gashi B.I. Argumentimi në raportin e eksperteve është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish. Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga AK, por që vlerësohet se me kthimin e këtij aktiviteti të prokurimit në Rivlerësim AK do ti trajtoj të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojnë në mënyrë transparente, si dhe të veprojnë konform rekomandimeve të lartcekura përfshirë atë se AK duhet të kërkojë dëshmi shtesë për të dëshmuar vërtetësinë e Listës së furnizimeve të realizuara si dhe referencat, sipas nenit 69 të LPP, po ashtu dëshmitë në lidhje me referencat dhe listën e kontratave, duke e respektuar nenin 8 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik si dhe Ligjin e Prokurimit Publik, Nenin 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim

#### *Konstatimet e panelit shqyrtues*

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjellojë sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në raportin e ekspertizës janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova

materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues, andaj paneli vendos që AK gjatë fazës së ri-vlerësimit të bëjë sqarimet konform nenit 59 dhe 72 të LPP.

*- Përfundim -*

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.







Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Gëzime S. Gashi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: